

VENDIM
Nr.17, datë 12.1.2011

PËR SHPRONËSIMIN SHITESË, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (KULTURA BUJQËSORE DHE DRU FRUTORË), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN-VLORË (SEKSIONI I DYTË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin shtesë, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (kultura bujqësore dhe dru frutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan–Vlorë (seksioni i dytë).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listat bashkëlidhur, për kultura bujqësore, me vlerë 1 862 222 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e dy) lekë, për dru frutorë, me vlerë 23 386 736 (njëzet e tre milionë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 25 248 598 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 3 210 000 (tre milionë e dyqind e dhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 25 248 598 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.1.2011 dhe të përfundojë më 15.5.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pronarët e përmendur në listat që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar ky proces, në bazë të konfirmimit zyrtar që do të jepet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, si dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Pronarët, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “I pasaktësuar”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i saktësimit nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, dhe pasi të jetë dhënë konfirmimi zyrtar i saj, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Nuk është saktësuar pronari nga ZRPP-ja”, pronarët pretendues të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i saktësimit nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Vlorë, dhe pas konfirmimit zyrtar nga kjo zyrë për titullin e pronësisë, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7, 8, 9 dhe 10 të këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha